



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 18 , datë 10.05.2019

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË ZOTIT MITAT DAUTAJ, PËR SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI PËR GJYQJAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare/ Relatore
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare Dorina Dulaj,

Me praninë e Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- zotit Bledar Dervishaj, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- zonjës Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës 10.05.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDADI PËR GJYQJAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: Zoti MITAT DAUTAJ

OBJEKTI:

Tërheqje nga kandidimi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e vendit vakant të shpallur në datën 04.03.2019 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, zonjës Fatjona Memçaj,

mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit,

dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”*, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Bashkim Dedja.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe zoti Mitat Dautaj.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Fatjona Memçaj.

7. Zoti Mitat Dautaj, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Mitat Dautaj, gjendet e administruar në dosjes e kandidimit.

8. Në datën 08.04.2019, kandidati Mitat Dautaj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen kandidimit.

9. Në datën 24.04.2019, kandidati Mitat Dautaj ka paraqitur në rrugë elektronike në adresën e sekretarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një shkresë, me anë të së cilës, njofton Këshillin se ka vendosur të tërhiqet nga kandidimi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese. Kjo shkresë, e paraqitur pranë Këshillit në rrugë elektronike mban datën 24.04.2019, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit dhe një kopje i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Në zbatim të pikës 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtar i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019, ka njoftuar Këshillin lidhur me vullnetin e shprehur nga kandidati Mitat Dautaj për tërheqjen nga kandidimi për këtë vend vakant, duke përgatitur dhe dërguar për shqyrtim relacionin dhe projektaktin përkatës mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të këtij kandidati.

11. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 10.05.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zotit Mitat Dautaj, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019.

12. I njëjti njoftim, së bashku me materialet e çështjes i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

13. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 10.05.2019 dhe rendin e ditës janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

14. Në mbledhjen e Këshillit, pas relativitetit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

15. Në thelb, Avokati i Popullit parashtrroi se; procedura e ndjekur nga ana e këshillit është në zbatim të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “ Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante të Gjykatës Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Gjithashtu, rezultoi se vullneti i kandidatit për tërheqje nga kandidimi është i qartë sipas aktit të dorëheqjes të paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

16. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit Mitat Dautaj.

17. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

“1. shpall në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Pranë Kuvendit paraqiten aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të këtij ligji.

2. Kuvendi, brenda 30 ditëve nga hapja e procedurës së aplikimit, publikon listën e kandidatëve dhe ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

18. Në zbatim të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 234 e vijues të Ligjit nr. 115/2016, pas dërgimit të listës së kandidatëve që kanë shprehur interes së bashku me dokumentacionin e paraqitur, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar në datën 05.04.2019 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

19. Ligji nr. 8577/2000 dhe Ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në raste të tilla.

20. Por, nga ana tjetër, Ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se :

“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.

21. Bazuar në këtë detyrim dhe delegim ligjor për të miratuar, në bazë dhe për zbatim të ligjit, rregulla më të detajuara normative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë aktin nënligjor normativ, vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.*

22. Në lidhje me rastin e tërheqjes nga kandidimi, në vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në pikat 8 dhe 31 të tij, parashikohet se :

“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.”.

“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.”.

23. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore normative të zbatueshme në rastin e tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatit Mitat Dautaj. Kandidati është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, sipas rrugës elektronike në datë 05.04.2019.

24. Gjithashtu, nga aktet që përmban dosja e kandidimit, rezulton që kandidati Mitat Dautaj, në datën 24.04.2019, ka paraqitur në rrugë elektronike në adresën e sekretarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një shkresë, me anë të së cilës, njofton Këshillin se ka vendosur të tërhiqet nga kandidimi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019. Kjo shkresë, e paraqitur pranë Këshillit në rrugë elektronike mban datën 24.04.2019, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

25. Këshilli vlerëson të rregullt në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur prej këtij kandidati për tërheqjen nga kandidimi, shkresën e paraqitur për këtë qëllim nga kandidati Mitat Dautaj.

26. Këshilli vlerëson që shprehja e interesit dhe kandidimi për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

27. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet në Gjykatën Kushtetuese, atëherë nuk ka më vend të vijojnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 dhe 3 të nenit 229 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikave 8 dhe 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zotit Mitat Dautaj, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Mitat Dautaj.
3. Kandidati Mitat Dautaj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI

